



Mekanizmi i Referimit për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm

Qasje konsultuese mbi përzgjedhjen e një mekanizmi efektiv

Klejda Ngjela, Qendra CVE

Cilat mekanizma janë krijuar deri më tani?

- Mekanizmi i referimit të dhunës në familje;
- Mekanizmi kundër trafikut të qënieve njerëzore;
- Mekanizmi për fëmijët në rrezik;
- Shkolla si qendër komunitare;
- Këshillat lokale për sigurinë publike;
- Policimi në komunitet;

Mekanizmi i referimit të dhunës në familje

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi kanë këto detyra:

Krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;

Ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve;

Ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

Marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja,

Marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;

Bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes.

Përveç autoriteteve përgjegjëse administrative në nivel qendror, kundër dhunës në familje vepron edhe një mekanizëm referues në nivel vendor. Ky mekanizëm është i përbërë nga tre struktura:

Komiteti drejtues - Identifikon problemet dhe propozon zgjidhje, përcakton rregullat e funksionimit të ekipit teknik ndërdisiplinor, etj.

Ekipi teknik ndërdisiplinor – menaxhon rastet dhe plotëson nevojat e viktimave, koordinon mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve, monitoron dhe raporton në komitetin drejtues, etj.

Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare - drejton dhe koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor, ndërmjetëson me institucionet e përfshira dhe OJF-të, asiston viktimat për ndjekjen e procedurave dhe plotësimin e dokumentacionit, etj.

- Mekanizmi kundër trafikut të qënieve njerëzore

Në nivel prefekturë dhe nënprefekturë janë krijuar dhe funksionojnë komitetet rajonale të luftës kundër trafikut të qënieve njerëzore, grave dhe fëmijëve, me qëllim mbikqyrjen dhe bashkërendimin e veprimeve qeveritare dhe joqeveritare për parandalimin e këtij fenomeni dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Këto komitete kryesohen nga **prefekti i qarkut** dhe nënprefekti në nivel bashkie dhe kanë në përbërje kryetarin e bashkisë, si dhe drejtues të shërbimit social, të punësimit, të Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ Shtetëror, të arsimit dhe të shëndetit publik.

Komitetet Rajonale të Luftës kundër trafikut të qënieve njerëzore janë përgjegjëse për identifikimin e problemeve parësore në përputhje me Strategjitë Kombëtare Antitrafik, si dhe për vlerësimin e gjendjes dhe përcaktimin e nevojave specifike të qarkut/bashkisë. Për identifikimin e problemeve parësore, për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe përcaktimin e veprimeve të nevojshme për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e qytetarëve të rrezikuar, anëtarët e komitetit caktojnë persona teknikë nga sektorët e tyre përkatës dhe në këtë mënyrë formojnë tryezën teknike rajonale antitrafik.

Komitetet dhe nënkomitetet antitrafik kanë në fokus të punës së tyre qytetarët e rrezikuar siç janë grate/vajzat e papuna e të paarsimuara, si dhe fëmijët e tyre. Kjo kategori është njësoj e rrezikuar të përfshihet në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm, çka bën që funksionimi i komiteteve antitrafik ti shërbejë parandalimit në një spektër më të gjërë.

Puna parandaluese që zhvillojnë komitetet dhe nënkomitetet antitrafik për reduktimin e braktisjes së shkollave, tërheqjen e fëmijëve të rrugës në bankat e shkollës, si dhe për rritjen e bashkëpunimit me psikologët dhe punonjësit sociale për fëmijët që vijnë nga shtresat e rrezikuara, i shërbejnë njësoj dhe parandalimit të hershëm të ekstremizmit të dhunshëm.

Puna parandaluese që zhvillojnë komitetet dhe nënkomitetet antitrafik për reduktimin e braktisjes së shkollave, tërheqjen e fëmijëve të rrugës në bankat e shkollës, si dhe për rritjen e bashkëpunimit me psikologët dhe punonjësit sociale për fëmijët që vijnë nga shtresat e rrezikuara, i shërbejnë njësoj dhe parandalimit të hershëm të ekstremizmit të dhunshëm.

- Mekanizmi për fëmijët në rrezik;

Mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, përbëhet nga:

- Komiteti Drejtues “Për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel vendor, për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik”;
- Grup Teknik Multidisiplinar;
- Njësia për të Drejtat e Fëmijës në nivel qarku;
- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në nivel bashkie/komune.
- Në nivel bashkie funksionon grupi teknik multidisiplinar dhe njësia për mbrojtjen e fëmijëve. Shërbimi i mbrojtjes së fëmijëve duhet të jetë aktiv 24 orë në ditë, në çdo njësi të qeverisjes vendore. Kjo supozon që çdo bashki të garantojë shërbime të ndërhyrjes dhe pritëse, për t’u ardhur në ndihmë fëmijëve në çdo orë të ditës dhe të natës.
- Problematikat kryesore që hasin njësitë e mbrojtjes së fëmijëve lidhen me situatën e vështirë ekonomike të familjeve, braktisjen shkollore ose mosregjistrimin, dhunën në familje, trafikimin, shfrytëzimin e fëmijëve, probleme me aftësinë e kufizuar, çka janë njëkohësisht dhe problematika që lidhen shtresat në nevojë dhe për pasojë dhe me çfaqjet e ekstremizmit të dhunshëm.
- Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve janë të angazhuara në fushata kombëtare të informimit dhe ndërgjegjësimit në shkolla për Sigurinë e Fëmijëve në Internet. Objekt i këtyre fushata mund dhe duhet të bëhet dhe rreziku i radikalizimit online.
- Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve trajtojnë dhe menaxhojnë dhe raste të fëmijëve me probleme shëndetësore, përfshi ato të shëndetit mendor (sjelljet antisociale dhe agresive, mungesë përqendrimi dhe hiperaktivitet), adresimi me seriozitet të cilave ndihmon në parandalimin e akteve të dhunës.
- Bashkëpunimi i mirë që kanë e mbrojtjes së fëmijëve me organizata e shoqërisë civile dhe ekzistenca dhe funksionimi i linjave të këshillimit (Alo 116), janë arsye me shumë për dobinë e mekanizmi në funksion të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Shkolla si qendër komunitare;

Shkolla si qendër komunitare është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit Sportit në vitin 2013, me qëllim për të ridimensionuar dhe përmirësuar cilësinë dhe rolin e shkollës dhe sistemit arsimor shqiptar, jo vetëm në komponentin e mësimdhënies dhe të nxënësve, por edhe për hapjen e shkollës ndaj komunitetit. Nisma synon ta kthejë shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet.

Ekipi koordinues i shkollës si qendër komunitare përbëhet nga drejtori (ose nëndrejtori) i shkollës i cili është dhe drejtues i ekipit, anëtarë të bordit të prindërve, përfaqësues të qeverisë së nxënësve, mësues të shkollës, përfaqësues të pushtetit vendor si dhe përfaqësues të partnerëve të tjerë sociale. Ky ekip, nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose një ekipi të ngritur enkas, angazhohet në procesin e vlerësimit të nevojave dhe burimeve.

Veprimtaritë e parashikuara të shkollës si qendër komunitare grupohen në katër lloje:

- Konsultimet/kurse/klube që ngrihen mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë dijet në një fushë të caktuar apo dhe fushave të tjera kurrikulare. Shkolla ndërton kurse akademike të cilat nuk i mbivendosen programeve dhe përvojave të nxënësit në orën e mësimi.
- Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv. Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave.
- Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv. Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave.
- Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv. Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave.

Këshillat lokale për sigurinë publike;

Këshillat funksionojnë në bazë të rregulloreve të miratuara nga anëtarët e këshillit, ku janë parashikuar qëllimi, struktura, si dhe modalitete të drejtimit, sekretariatit, bashkëpunimit, dhe raportimit. Rregullorja parashikon gjithashtu ngritjen e grupeve të veçanta (ad hoc), bazuar në shqetësimet specifike lokale.

Këshilli drejtohet nga kryetari i bashkisë dhe ka në përbërje të Policisë së Shtetit, policisë bashkiake, shërbimeve sociale, administrata e arsimit, shërbimi shëndetësor, administrata e pyjeve dhe mjedisit, prefektura, shoqëria civile, komunitetet fetare, komuniteti i biznesit, media lokale, grupet vullnetare, etj. Vendimet e marra në këshill i dërgohen në formë rekomandimesh institucioneve përgjegjëse lokale, të cilat nga ana e tyre raportojnë mbi aktivitetet e kryera për përmirësimin e problemeve të sigurisë publike të adresuara nga këshilli.

Në mungesë të një mekanizmi të posaçëm për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, këshillat e sigurisë lokale janë forumi i përshtatshëm për të adresuar një pjesë mirë të problematikës lokale, që nuk mund të trajtohet në mekanizmat referuese ekzistuese.

Në këshillat lokale të sigurisë mund të adresohen faktorët shtytës në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm si përjashtimi, pabarazia, diskriminimi, mohimi të drejtave dhe lirive civile, etj., dhe faktorë tërheqës si ekzistenca e grupeve ekstremiste lokale, predikimet e deformuara të udhëqësve ideologjikë/shpirtërorë, etj.

Këshilli lokal i sigurisë lehtëson komunikimin dhe bashkëpunimin midis dy aktorëve kyç të sigurisë lokale dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm; kryetarin e bashkisë dhe shefin e komisarit të policisë.

- Policimi në komunitet;

Modeli i policimit në komunitet mbështetet në tre shtylla kryesore

Partneriteti me komunitetin. Bazuar në konceptin që komuniteti/qytetarët duhen të jenë pjesë e zgjidhjes të problemeve të sigurisë duke krijuar ndjenjën e përgjegjësisë së përbashkët.

Adresimi i shkaqeve që çënojnë sigurinë. Bazuar në parimin e proaktivitetit dhe të punës parandaluese për adresuar shkaqet që çënojnë sigurinë në komunitet apo faktorevë të tjerë stimulues.

Përmirësimi organizativ. Bazuar në parimin se për të qënë në gjendje të ofrojë shërbime cilësore ndaj komunitetit, Policia duhet të udhëhiqet nga standarde të larta profesionale dhe etike.

Policimi në komunitet në nivel bashkie gjen zbatim në dy nivele; strategjik dhe teknik.

- **Strategjik.** Në secilën nga 61 bashkitë e krijuara me territoriale (përjashto Tiranën) funksionon një komisarjat ose stacion policie.
- Në përputhje me filozofinë e policimit në komunitet, çdo komisarjat/stacion policie harton planet vjetore të sigurisë vendore në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin në përgjithësi dhe në veçanti me aktorët kyç lokalë qeverisës, vetëqeverisës dhe të shoqërisë civile.
- Element i rëndësishëm i planifikimit strategjik është matja e gjendjes të sigurisë në komunitet nëpërmjet anketimit të perceptimit të qytetarëve në zona (lagje) për problemet e rendit/sigurisë dhe vlerësimin e tyre për punën e policisë. Gjetjet e anketimit, sëbashku me statistikën policore, analizohen me qëllim identifikimin e shkaqeve dhe faktorëve që çojnë në problemet e sigurisë në zone dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e ndërhyrjeve.
- **Teknik.** Në të gjithë territorin e vendit, në një/disë lagje të caktuara të një qyteti apo një bashkësie të fshatrave, funksionon struktura e oficerit të policimit në komunitet, përgjegjës për zonën policore.
- Oficeri i policimit në komunitet mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e komuniteteve në atë zonë, njeh shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve, jep ndihmën e drejtpërdrejtë për qytetarët, parandalon sjelljet antishoqërore dhe dokumenton veprat penale. Ajo/ai udhëhiqet nga parimet bazë të policimit: “shërbim policor përfaqësues, i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i kontrollueshëm”
- Aktivitetet të tjera që organizohen në kuadër të policimit në komunitet, janë organizimi i ditës së dyerve të hapura të policisë, zhvillimi i temave të prandalimit të krimit në shkollë, organizimi i fushatave ndërgjegjëse për dhunën në familje, qarkullimin rrugor, krimin kompjuterik, etj. Në modelet më të mira ndërkombëtare, policia ndërverpron me të rinjtë edhe nëpërmjet rrjeteve sociale, si dhe patrullon sëbashku me civilë vullnetarë zonat e nxehta.

????? Pyetje ?????